



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1035/2 prot

Datë 29.04.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-95967-02-21-2024, me objekt: “Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore”, me fond limit 17,458,400.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier
- Ankimues:** “Eco Riciklim” SHPK me NIPT L61814009B dhe adresë: Pasuria Nr. 1070, Zona Kadastrale 3965, Metalurgji, Bradashesh
- Autoriteti Kontraktor:** Spitali Rajonal “Memorial” Fier me adresë: Qender,Afrimi i Ri, Rruga “Daullas Grecalli” Nr 17, Daullas, Fier
- Subjekte të Interesuara:** “V.A.L.E Recycling” SHPK me NIPT L28029301Q dhe adresë: Gurez Fushe Kuqe Lezhe Fushe Kuqe, GUREZ, Fshatin Gurez,afer ish-Kanalit te Acidi

Në datën 29.04.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4024 dhe me nr. 1035/2024 prot., datë 29.04.2024 e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti

*kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK me anë të ankesës me numër ankimi elektronik A/2024/4024 dhe me nr. 1035/2024 prot., datë 29.04.2024, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK të kriterëve si më poshtë:

### *2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:*

***Kriteri 2.1.2.*** *Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponoje:*

*1.Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe*

*2.Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:*

*- 18 01 02 - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03);*

*- 18 01 09 - Medikamente te tjera pervec atyre te permendura ne 18 01 08*

***Kriteri 2.3.3 :*** *Operatori ekonomik duhet te paraqese Akt Miratimin Higjeno –Sanitar respektiv per objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shëndetësor Shtetëror).*

***Kriteri 2.3.4:*** *Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt te lejuar nga AKM per depozitimin e produktit final qe del nga asgjесimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave.*

***Kriteri 2.3.6:*** *Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, apo nepermjet cdo menyre posedimi te njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798, date 29.09.2010, per miratimin e rregullores Per administrimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:*

*a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1 dhe impiant back up me të njëjtën metodë;*

b. *Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1 dhe impiant back up me të njëjtën metodë;*

c. *Makineri për larjen e kontenierëve cope 1 dhe makineri back up të tillë (vetëm në rastin kur do të përdoren konteniere të ripërdorshëm);*

*Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:*

a) *Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);*

b) *Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;*

c) *Katalog ose skedë teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;*

d) *Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 29.04.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**